



## UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” – KORÇË

organizon

### KONFERENCËN KOMBËTARE STUDENTORE

### “ROLI I GRUAS NË SHOQËRI DHE SFIDAT E BARAZISË GJINORE”

në bashkëpunim me

**FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE, UNIVERSITETI I TIRANËS**

**UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

**25 MAJ 2023**

**KORÇË**

### **THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCË**

Roli i gruas në shoqëri dhe barazia gjinore janë thelbësore për një demokraci gjithpërfshirëse dhe zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik. Ndërsa punojmë për të përmbushur objektivat e përcaktuara ndërkombëtarisht për të zhdukur varfërinë, urinë, diskriminimin apo sëmundjet që pengojnë zhvillimin njerëzor, arritja e barazisë gjinore ende vazhdon të mbetet një sfidë globale. Garantimi i të drejtave të grave dhe dhënia e mundësive për të arritur potencialin e plotë është thelbësore jo vetëm për arritjen e barazisë gjinore, por edhe për përmbushjen e një game të gjerë objektivash të zhvillimit ndërkombëtar. Çështje të barazisë dhe përfaqësimit gjinor, mirëkuptimi socio-politik dhe kulturor, përpjekjet sociale për të luftuar praktikatat diskriminuese, etj janë ndër çështjet kryesore që kërkojnë vëmendjen e shoqërisë dhe të gjithë aktorëve social.

Qëllimi i kësaj konference është të bëjë bashkë studentët dhe kërkuesit e rinj të disa universiteteve jo vetëm në shenjë ndërgjegjësimit rreth çështjes së barazisë gjinore, por edhe të kontribuojë në identifikimin e sfidave të reja dhe praktikave më të mira për kapërximin e barrierave me të cilat përballën gratë. Kjo konferencë do të organizohet në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, si dhe me Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Konferenca është konceptuar si një ngjarje e organizuar për të ofruar një platformë kombëtare për studentët, kërkuesit e rinj si dhe ekspertë të fushës për të ndarë së bashku idetë, përvojat dhe gjetjet e tyre kërkimore, të cilat do të publikohen në një përmbledhje të posaçme me punimet kontribuese në konferencë.

Gjatë kësaj veprimtarie do të shfaqet dhe një dokumentar i përgatitur nga studentët e Universitetit “Fan S. Noli” me në qendër temën e konferencës.

## **Tematikat bazë të konferencës, (por jo të kufizuara):**

- *Forca e gruas e shprehur përmes historisë;*
- *Politikat sociale dhe çështjet gjinore;*
- *Media, komunikimi dhe çështjet gjinore;*
- *Diskriminimi gjinor i perceptuar në vendin e punës;*
- *Gruaja si sipërmarrëse në biznes;*
- *Gruaja si sipërmarrëse në kauza sociale;*
- *Përfshirja e grave në politikë*
- *Stereotipet gjinore dhe pabarazia gjinore*
- *Edukimi- receta e duhur për të “shëruar” plagët që ka lënë e kaluara në shoqërinë shqiptare.*
- *Barazia gjinore dhe roli i edukimit*
- *Rrjetëzimi për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje*
- *Barazia gjinore dhe globalizmi*
- *Migrimi dhe çështjet gjinore*
- *Fuqizimi i grave dhe ndryshimi social*
- *Gratë dhe e ardhmja e feminizmit*

## PREZANTIMI NË KONFERENCË:

- Fizik;
- Prezantim me poster, sipas modelit që vijon (<http://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Conference-POSTER.pdf> ).

## GJUHA E PREZANTIMIT: SHOIP

### Data të rëndësishme:

- Publikimi i thirrjes për pjesëmarrje 24 janar 2023
- Afati për dorëzimin e abstraktit – 24 mars 2023
- Lajmërimi për pranimin e abstraktit – 4 prill 2023
- Publikimi i programit të konferencës – 7 maj 2023
- Data e konferencës – **25 maj 2023**
- Afati për dorëzimin e punimit të plotë – gusht, 2023
- Publikimi i punimeve (Proceeding book-online) – Shtator 2023

### Bordi Shkencor i konferencës:

- Prof.dr. Dhimitri Bello, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Benita Stavre, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.asoc.dr. Elvira Fetahu, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.
- Prof.as.dr. Jonela Spaho, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Sonela Stillo, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Ledina Alolli, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Gjergji Mero, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Arto Adili, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Blerina Hamzallari, Universiteti i Tiranës
- Prof.as.dr. Besnik Skënderasi, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Gjergji Papa, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Ilir Sosoli, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Anyla Saraçi, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Albina Pajo, Universiteti “Fan S. Noli”
- Phd. Daniela Stoica, Universiteti “Fan S. Noli”
- Phd. Metin Venxha, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Oriola Theodhori, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Suela Gërdhe, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof.as.dr. Anila Maçka, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Rafail Prodani, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof. as. dr. Magdalini Vampa, Universiteti “Fan S. Noli”
- Msc. Blendi Baze, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Desareda Mero, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Lorena Kelo, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Denisa Titili, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Orion Ago, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Emil Frashëri, Universiteti “Fan S. Noli”
- PhD. Jordan Jorgji, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Elda Nuni, Universiteti “Fan S. Noli”

**Universitetet që do të realizojnë recensat e punimeve të konferencës:**

1. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;
2. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës;
3. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

**Komisioni organizues:**

1. Elena Tona, Biblioteka Shkencore, Universiteti “Fan S. Noli”
2. Katerina Çifligu, Sektori i Informacionit dhe Promocionit, Universiteti “Fan S. Noli”
3. Fotjola Stillo, Sektori i Projekteve dhe Kërkimit, Universiteti “Fan S. Noli”
4. Erjona Asabella, Sektori i Projekteve dhe Kërkimit, Universiteti “Fan S. Noli”
5. Eftiona Bylykbashi, Sektori i Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Universiteti “Fan S. Noli”
6. Romeo Terrolli, Qendra e Karrierës dhe Alumni, Universiteti “Fan S. Noli”
7. Studentë

**Vendi ku do të zhvillohet konferenca:**

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, “Fan S. Noli”  
University, Address: Shëtitörja “Rilindasit”, 7001, Korçë,  
ALBANIA.

**Kontakte:**

**Sekretaria e konferencës:**

**Elena Tona**

[etona@unkorce.edu.al](mailto:etona@unkorce.edu.al)

Ose vizitoni linkun zyrtar të konferencës:

## **Mundësitë e publikimit**

Vetëm autorët që do të marrin pjesë me punimet e tyre (fizikë ose me poster) do të kenë mundësinë ta botojnë artikullin e tyre në përmbledhjen e posaçme që do të përgatitet me këto punime.

Punimet e dorëzuara do të pranohen për t'u botuar vetëm pasi të kalojnë procesin e peer review nga ekspertët e Universiteteve organizatore.

Punimet e përzgjedhura për botim pas procesit të recensave, do të publikohen në një botim të posaçëm, i pajisur me ISBN dhe do të publikohet online në faqen elektronike zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli", brenda muajit shtator 2023.

## **Formati i artikullit për publikim:**

**Titulli i punimit:**

**Autori/ autorët:**

**Adresa e e-mail-it**

**Përmbledhja/ Abstrakti:**

**Fjalët kyçe:**

**Përfundime:**

**Referenca:**

**Titulli:**

Titulli i punimit duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe informues (CAPITAL letters font 14, bold). Titulli, emri/at i/e autorit/ëve, Universiteti nga vijnë, si dhe adresat e tyre të e-maile-ve duhet të vendosen në qendër të faqes së punës.

**Përmbledhja/ Abstrakti:**

Përmbledhja duhet të dorëzohet në **gjuhën shqipe dhe në atë angleze** (deri në 250 fjalë; 11 pt Times New Roman, line spacing 1)

**Fjalët kyçe:** 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (11pt Times New Roman, Normal)

**Artikulli duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word 2007.** Font: 12 pt Times New Roman, single line (justified), line spacing 1, deri në 6 faqe, format A4.

**Citimet brenda tekstit duhet t'i referohen modelit APA:** <https://www.citationmachine.net/apa>

**Formati i bibliografisë:** <https://www.citationmachine.net/apa>